



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

KRYESIA

Tiranë, 6 qershor 2024

Letër ngushëllimi

I nderuar akad. Kraja, të nderuar kolegë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,

Njoftimi për ndarjen nga jeta të piktorit të njohur, akademikut Rexhep Ferri, solli dhimbje e hidhërim të thellë në Akademinë tonë.

Me ndarjen nga jeta të tij familja humbi njeriun e saj të dashur, ASHAK anëtarin e denjë të saj, ASHSH kolegun e vet të nderuar, Vlora qytetarin e saj të nderit dhe kultura shqiptare një personalitet të spikatur.

Jeta e tij, e mbushur me aktivitet artistik, kulturor e botues, e vendosi personalitetin e tij në bashkësinë e nderuar të akademikëve të Kosovës, midis personaliteteve më të shquar të kulturës shqiptare. Me ekspozitat e shumta dhe botimet e tij ai ka përçuar modelin e artit e vet kudo ku ndodhen sot shqiptarët dhe në mjedise ndërkombëtare. Vepra e tij do të nxisë për arritje të tjera në artet figurative.

ASHSH shpreh ngushëllimet e saj të ndjera për familjen e akademikut Rexhep Ferri; për kolegët akademikë të ASHAK dhe për gjithë bashkësinë e artkrijuesve dhe artdashësve të kulturës shqiptare.

Akad. Skënder Gjinushi

Kryetar